

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 5 TETOR 2023

Të nderuar kolegë,

E nderuar Kryetare,

Të dashur qytetarë,

Projektligji i sjellë sot në Parlament është shumë i rëndësishëm, madje një ndër projektligjet që është përdorur si jo rrallëherë nga kjo mazhorancë për t'i detyruar qytetarët që ta votojnë. Më kujtohet që ky ligj u miratua në prag të zgjedhjeve të vitit 2019 dhe, në fakt, ua prishi mendjen jo vetëm socialistëve, por edhe demokratëve për ta votuar. Në fakt, ishte një iniciativë pozitive, por e pamjaftueshme për situatën që po kalonte Shqipëria, sepse në këta 10 vjet, si asnjëherë tjetër, më shumë se 1 milion shqiptarë kanë ikur jashtë vendit. Nuk mjaftohemi vetëm me këtë trend negativ për Shqipërinë, por më e keqja është se nga vendi me moshën mesatare më të ulët apo më të re, ne sot jemi vendi me moshën mesatare më të lartë të popullsisë në Europë, çka ka sjellë rritje të numrit të pensionistëve dhe një rënie drastike të lindjeve, saqë në vitin 2021, për herë të parë ndoshta në historinë më shumë se shekullore, vdekjet i tejkaluan lindjet. Nëse do t'i referohemi vetëm këtij projektligji të miratuar në fillim të vitit 2019, shohim që ishte një ligj i cunguar, madje një ligj që i ngjante atij të Kinës. Në Kinë, kush bënte më shumë se dy fëmijë, penalizohej. Në fakt, edhe Kina e pësoi nga kjo, sepse sot, edhe për shkak të atij ligji, renditet e dyta, nga e para që ishte në botë. Në fakt, qeveria shqiptare, në vitin 2019, kur kishte nevojë për të stimuluar lindjet, i kufizoi ato vetëm në 3. Kush e kishte lindje të katërt, të pestë, të shtatë, të dhjetë apo më shumë, nuk merrte asnjë lek. Pra, kishte një legalizim vetëm për 3 fëmijë. Kjo ishte vërtet e paimagjinueshme dhe nuk ndikoi aspak, po themi, në stimulimin e rritjes së popullsisë. Nuk u mjaftua me aq, por duke parë se trendi i personave që shkonin jashtë Shqipërisë ishte në rritje, madje, po të shohësh shpërndarjen e bonusit për vitin 2022, 43% prej tyre ishin me banim jashtë Shqipërisë dhe vetëm 57% ishin në Shqipëri (nëse lista e atyre që janë jashtë shtetit është e saktë), qeveria, me ngut, nuk e pa oportune votën e tyre apo interesin e lidhur me këta persona dhe ndërmori një iniciativë, që bonusi i atyre që emigrojnë jashtë, që ishte 43% vitin e kaluar (por jam i sigurt që këtë vit është shumë i lartë dhe, pse jo, me këtë trend do ta tejkalonte lindjen e fëmijëve brenda Shqipërisë), të refuzohej.

Kjo është vërtet kriminale për një vend si Shqipëria dhe vazhdon të japë impaktet e saj negative jo vetëm në numrin e popullsisë së tkurrur, por edhe në ndryshimin e balancës së pensionistëve. Nga 1 kontribues, që ishte para 15 apo 20 vjetësh, sot kemi bars një kontribues me një pensionist, e me këtë trend jam i sigurt që do të jetë 1 kontribues për dy pensionistë. Kjo është vërtet për të ardhur keq. Qeveria nuk bëri ndonjë shpikje, se ky ishte trendi edhe i mëparshëm, por rriti masën e shpërblimit të bonusit për një, dy apo tre fëmijë. Vendet e tjera të botës e aplikojnë, madje bëjnë edhe stimuj të tjerë, duke u dhënë shtëpi, duke siguruar vende pune, duke dhënë asistencë sociale. Heqja e bonusit për këtë kategori është vërtet kriminale, është e papranueshme. Kur vjen momenti për të bërë deficitin tregtar në Shqipëri, rrofshin remitancat që e ngushtojnë këtë deficit tregtar, sepse me miliona euro vijnë nga kursimet e emigrantëve jashtë shtetit! Kur vjen puna për të numëruar turistët në Shqipëri, i numërojmë si turistë të huaj, edhe një herë, edhe pesë herë, nëse ai vjen brenda vitit, por nëse vjen për t'i dhënë bonusin, ne i themi emigrantit: "Jo, ti nuk je shqiptar; ti nuk mund të përfitosh nga bonusi i bebes". Kjo është shumë e dhimbshme. Akoma më tej, nëse sot do të shohim treguesit e tjerë në Shqipëri, si mundet të bëhet, po themi, kjo iniciativë, kur në Shqipëri aftësia blerëse e qytetarëve është sa 32% e mesatares së Bashkimit Europian, pra më pak se 1/3, dhe kjo është shumë

e dhimbshme, madje me një diferencë të theksuar me vendet e rajonit, që janë shumë herë më lart se Shqipëria? Nëse i referohemi sërish Eurostat-it, konsumi individual për frymë në Shqipëri është në shifrën më të ulët, vetëm 39%, në dallim nga vendet e tjera, ku më afër Shqipërisë është, po themi, Bosnjë dhe Hercegovina me 47%, apo mesatarja e vendeve të rajonit është mbi 48%, çka do të thotë se edhe në këtë tregues Shqipëria është renditur në fundin e listës jo vetëm për rajonin, por edhe për Evropën. Nëse i referohemi një treguesi tjetër në lidhje me të ardhurat për frymë, po prapë do të shohim se Shqipëria është e fundit në rajon. 69% e të punësuarve në Shqipëri, sipas Eurostat-it, nuk plotësojnë nivelin e minimumit jetik. Në Shqipëri, si në asnjë vend tjetër, kemi vetëm 5 dollarë në ditë, çka do të thotë se është jashtë çdo lloj logjike. E nëse pastaj i referohemi mbështetjes sociale që jep qeveria, do të shohim se kemi shifra absolutisht të paimagjinueshme. Mjafton të shohim ndihmën ekonomike. Një familje me ndihmë ekonomike, që ka katër persona, trajtohet vetëm me 6200 lekë. Kjo do të thotë se një person përfiton vetëm 1500 lekë, që, konvertuar në euro, i takon të jenë vetëm 12 euro në muaj. Pra, jo pesë euro në ditë, por 12 euro në muaj. Kjo do të thotë se 1 euro duhet ta shpenzojnë për dy ditë e gjysmë, për të mbyllur muajin. Këto janë shifrat, të cilat qeveria duhet t'i ketë lexuar dhe duhet t'i dijë shumë mirë, por që në asnjë lloj rrethane nuk përdor instrumente për ta ndaluar hovin e emigrimit të njerëzve, që nuk i mbijetojnë dot situatës në Shqipëri. Ndërkohë, nuk ndërmerr masa. Në fakt, sot unë prisja që ky projektligj të kishte ardhur për të rritur edhe një herë gamën e mbështetjes, duke mos e kufizuar me tre, por pa limit, madje duke shtuar dhe masën e përdorimit të instrumenteve të tjera, siç përdoren në vendet e tjera të rajonit, të Europës apo të botës, që të rritet numri i popullsisë, pasi mund të japë efekte të jashtëzakonshme, të paimagjinueshme për qytetarët. Do të ishte absurde për këtë qeveri nëse do ta miratonte këtë ligj, sepse kësaj do t'ia kalonim dhe Kinës sa i takon kufizimit që bëjmë për ata që lindin më shumë se tre fëmijë, por edhe për gjysmën e popullsisë që gjendet jashtë shtetit. Në fakt, ky absurditet vazhdon akoma edhe sa u përket treguesve të tjerë. Sa herë që e majta vjen në pushtet, konsiderohet si qeverisje me prirje sociale, por në të vërtetë të gjithë treguesit janë regresivë gjatë këtyre dhjetë vjetëve, të pakrahasueshme jo vetëm me historikun e Shqipërisë, por edhe me vendet e rajonit dhe vendet e tjera në botë. Madje kjo më duket si një lloj filozofie e qeverisjes së majtë, që siç thotë dhe gazetari, historiani dhe shkrimtari italian Indro Montanelli: "E majta i do aq shumë të varfrit sa, kur vjen në pushtet, e shton numrin e tyre."

Faleminderit!